

Procesverbal

Nga mbledhja e II - (dytë) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 02.03.2023 dhe 03.03.2023

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e II-të,
- 3) Eventuale...

Uran Halimi: Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes edhe faleminderit për pjesëmarrjen! Po fillojmë me mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2023 për KPF, ku siç edhe ju servue materiali, është paraparë ky rend i ditës: në pikë të parë është miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, pika e dytë është shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e dytë, dhe pika e tretë dhe e fundit është eventuale. Nëse do me e marrë fjalën dikush edhe me shtue diçka? Artani e ka kërkuar fjalën.

Artan Loshaj: Miërmengjesi, përshëndetje për të gjithë! Zotni kryesues, edhe kryetar, se ju jeni ata që e boni rendin e ditës, unë si delegat e kam një shqetësim se, për mu, është shumë e ngarkume kjo seancë, për dhjetë minuta me marrë tetë drejtori, edhe dy zyre, edhe zyra e kryetarit, njëmbëdhjetë raporte edhe njëmbëdhjetë plane, s'po na bjer as ka 30 sekonda me diskutue për secilin raport. Herave tjera është mirë ta keni parasysh, o raportin ta bini ni herë, e ni herë planin, se është e tepërt. Plus, i kemi edhe tri a katër pika të rendit të ditës, me këtë raport e me këtë plan mbi 500 faqe, veç me e marrë me shfletue po duhet dy-tri orë, e jo mo me diskutue, kur e dimë se 10 minuta është shumë pak. Thashë edhe ni herë, herën tjetër, në qoftë se ka mundësi, plani edhe raporti të vijnë ndaras. Falemnderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Loshaj! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është pro këtij rendi të ditës? Është fjala për rendin e ditës për KPF. Kemi gjashtë vota pro, zero kundër edhe një abstenim. Kalon rendi i ditës. Vazhdojmë te pika e parë, është miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kush është pro, ose nëse do me e marrë fjalën me shtue dikush në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar, përpara se ta hedhim në votim? Nëse jo, atëherë shkojmë me votim, kush është pro këtij procesverbali? Kundër? Abstenim? I kemi gjashtë vota pro, zero kundër, zero abstenim, edhe një e padeklaruar. Po vazhdojmë te pika e dytë e rendit të ditës, është shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e dytë. E dimë që në rend të ditës për seancën e cila është paraparë të mbahet nesër, janë këto pika të rendit të ditës: e

para është miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar , pika e dytë është vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023, është Raporti i Punës së KKSB-së për gjashtëmujorin e dytë për vitin 2022, pika e katërt është Raporti i Punës së ekzekutivit për vitin 2022 dhe Plan i Punës për vitin 2023, edhe pika e fundit është eventuale. Po vazhdojmë me pikën e dytë, është vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023. Nëse dikush do me e marrë fjalën në lidhje me këtë vendim? Këtë e kemi bo edhe vjet, qysh e di unë. Nëse do me e marrë fjalën dikush? Fjalën e ka kërkuar zotëri Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Të nderuar të pranishëm, duke pasur parasysh se jemi Komitetet për Politikë dhe Financa, pres disa sqarime shtesë rreth propozimit për shpenzimin e të hyrave vetanake për këtë vit. Ajo që më shqetëson është se fondet janë shumë të vogla nga të ardhurat personale. Kemi edhe më pak fonde se në vitin 2021. Viti që i parapriu viti i koronës, mbyllje, mos ardhje të diasporës dhe rrjedhimisht pagesa më të ulëta të taksave. Ky propozim është i çuditshëm për mua. Duke pasur parasysh se ky është mandati im i dytë dhe ndoshta leximi i pestë i propozimit për shpenzimin e të hyrave vetanake, ajo që është e çuditshme është se ju kryetar i Kuvendit nuk keni ndërmarrë asnjë veprim për ndarjen e mjeteve për Kuvendin. Nuk kemi asnjë ndarje të mjeteve për zyrën e Kuvendit dhe çdo vit kemi pasur së paku 10 mijë euro. Detyra juaj është të kujdeseni për zyrën dhe të kujdeseni për ne delegatët dhe ju është dashur të përfshini disa fonde për zyrën e kuvendit. Kemi rreth 100 mijë euro për subvencionimin e drejtorive të ndryshme. Unë dua të dëgjoj se për çfarë janë këto fonde. Kemi 290 mijë dhe tashmë kemi ndarë 100 mijë për drejtoritë që i kemi subvencionuar më parë. Sa i përket propozimit për investime kapitale, ne kemi një propozim që të ndahet një mur mbrojtës në fshatin Radesa, dhe se ka ardhur një kërkesë në komunë, une di për një kërkesë tjetër nga përfaqësuesi i këshillit të fshatit dhe unë, si anëtar i komisionit pyes se si duhet të trajtohet kërkesa e kryetarit, këshilli i fshatit nuk është miratuar, por është miratuar ndonjë kërkesë tjetër. Për mendimin tim, është dhënë ose sugjeruar në një kafe apo në ndonjë drekë. Nuk do t'i përmend Rabpçen dhe Globoçice, e kuptoj se këto janë projekte dyvjeçare dhe se është aq e nevojshme që këto investime kapitale të përfundojnë. 56.000 euro për automjete në shëndetësi, sa i përket arsimit dhe shëndetësisë, nuk komentoj kurrë. Mirëpo, kjo më befaso sepse vitin e kaluar kemi ndarë disa mijëra euro për nevojat e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

Uran Halimi: Faleminderit, Munir! Po besoj që këto përgjigje mundesh m'i marrë edhe nesër, besoj që nesër kanë me qenë prezent drejtorët, pasi që e kemi edhe ni raport shumë të madh, Artani

qysh tha, në lidhje me raportimin e drejtorëve. E di që është një material voluminoz, po unë po besoj që këtu duhet me bo përjashtime edhe me i dhënë ma shumë se 10 minuta kohë këtij raporti, se është e pamundur me u përfshi me 10 minuta. Kisha propozue që këto me i nda sipas drejtorive edhe me i dhonë ka 10 minuta secilës drejtori, nëse është mirë me raportue edhe e shihni të arsyeshme me raportue secili drejtor. Nëse do dikush tjetër me e marrë fjalën? Replikë? Patjetër.

Munir Jonuzi: Kryetar, të gjithë e keni dëgjuar, presidenti është i pranishëm këtu dhe do të na japë një përgjigje sepse ne si komision për politikë dhe financa meritojmë një përgjigje pak më të detajuar. Vetë emri i këtij komisioni do të thotë se ai merret me politikë dhe financa. Prisja që CFO ose zyrtari i lartë i financës të ishte i pranishëm. Asnjëri prej tyre nuk është i pranishëm sot në këtë takim. Dhe së dyti, mos u merr me pyetjet që i ngrita për ekzekutivin, merru me pyetjen që të ngrita, pse nuk është ndarë asnjë nga mjetet për zyrën e kuvendit.

Uran Halimi: Faleminderit, Munir, po ti nuk prite, se kryetari e lypi fjalën për me të dhënë përgjigje, po ti u ngute pak, s' e di pse, kështu që tash e kemi rastin kryetari me ta dhënë ni përgjigje, se ai mas teje... Munir, kryetari e lypi fjalën me të dhënë ty përgjigje, më fal që unë t' u përgjigja ty, nashta s' ke dashtë ni përgjigje prej meje, po mundesh me m' thënë që po e lypish ni përgjigje prej kryetarit.

Bexhet Xheladini: Atëherë ju përsëndes të gjithëve, i nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të Komitetit, ju përsëndes edhe ni herë, faleminderit që keni marrë pjesë sot në këtë takim. Unë do të mundohem t' i përgjigjem pyetjeve të cilat i parashtruan delegatët. Së pari, vërejtjen që e dhatë ju, na i kemi propozue pikat e rendit të ditës, mirëpo na mundemi me u marrë vesh, që disa drejtori mos me i shqyrtue nesër raportet edhe planet, me i shqyrtue në asamblenë e marsit. Mundim, për shembull, raportin e Zyrës së Prokurimit, zyrës për Komunitete dhe zyrës për Barazi Gjinore, edhe të Drejtoratit për Arsim, me e lonë me e shqyrtue në seancën e marsit. Mirëpo, nëse ju merreni vesh, mundim me i shqyrtue të gjitha nesër. Qysh të merreni vesh, nuk është problem, po vetëm në seancën e marsit kjo duhet me u krye. Sa i përket propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake, këto janë mjetet të cilat janë grumbullue jashtë propozimeve edhe jashtë planifikimit. Mjetet të cilat kanë qenë të planifikuara, 500 mijë euro të hyra vetanake, ato janë miratue në buxhetin e vitit 2023, në shtator të vitit të kaluar. Këtu bëhet fjalë vetëm për mjete të cilat janë mjete të bartura, që s' kanë mujt me u shpenzue vitin e kaluar, edhe mjete të cilat janë grumbulluar jashtë planifikimit. Bëhet fjalë për 254,513.00 euro. Dhe këto mjete ne i kemi nda sipas nevojave

dhe sipas kërkesave, shumica e këtyre mjeteve janë nda për projekte kapitale, për projekte dyvjeçare, për projekte të cilat na kemi kontrata. Për projekte që kemi kontrata, ato mjete na duhet me i nda, sepse mund të ju mbesim borxh operatorëve ekonomikë. Pjesa tjetër e mjeteve që kanë teprue, jemi mundue me i shpërnda nëpër drejtorate të ndryshme. Ju e keni marrë raportin, unë s'po due me ju lodhë me i lexue të gjitha. U tha këtu nga njëri prej asambleistëve që është fut në propozim ni projekt i ni muri mbrojtës në Radeshë. Nuk është e vërtetë që është marrë në kafehane, po ky propozim është marrë në debatin publik i cili është mbajtur në shkollën e fshatit Radeshë, për arsye se vitin e kaluar ka pas ni mosmarrëveshje, është bo ni gabim në implementimin e projektit, ku edhe pse ka qenë i paraparë ky mur me u ndërtue, është ndërtue diçka tjetër, për atë na kemi dashtë me e përmirësue gabimin. Mirëpo, te mjetet financiare të cilat i kemi propozue për Drejtoratin e Shëndetësisë, ju njoftoj se DSH i ka veç të ndara me buxhetin e vitit të kaluar 25 mijë euro për blerjen e një automjeti. Ne planifikojmë që këtë vit të blejmë ni autobus për nevojat e komunitetit joshumicë, për bartjen e nxënësve, dhe për këtë arsye ne kemi nda këto mjete, bashkë me ato me ble ni autobus. Mirëpo ne prapë, masi e kemi dhonë këtë propozim, kemi mendue që ndoshta mos do të ishte më mirë, mos të orientohemi që të blejmë autobus të ri, sepse po kushton shumë shtrenjtë, po do ta bëjmë kërkesën të blejmë ni autobus të përdorur. Dhe, unë dje kam bisedue me zyrën e Prokurimit, ligji po na lejojke, dhe ato mjete prej 56 mijë euro nuk do t'i lomë të gjitha për blerjen e autobusit, po faktikisht do t'i lëmë bashkë me mjetet e shëndetësisë 25 mijë, edhe këtu do t'i marrim disa mjete, do t'i lëmë 60 mijë. Kështu që po na mbesin disa mjete të lira, dhe këto pastaj mund t'i orientojmë edhe nëse doni në zyrën e Kuvendit, po unë e di që zyra e Kuvendit me buxhetin e vitit të kaluar është miratue edhe ka mjete, po nëse mendoni që mundemi m'i qit edhe 10 mijë, na mundim m'i qit, edhe në mbledhjen e nesërme të Asamblesë Komunale na do ta biem propozimin që këto mjete të cilat po teprojnë, sipas propozimit tonë ku duhet të orientohen. Nëse ju si delegatë pranoni, e voton, edhe nëse keni propozime të ndryshme, ato mujm edhe me i ndryshue. Kjo ishte e gjitha ajo që deshta me thonë për momentin, nëse ka paqartësi, unë muj prapë me dalë me bo sqarime. Edhe nëse ka nga ana e komunitetit të Radeshës ndonjë kërkesë që unë nuk e di, që është kërkesë edhe nuk u përfshi, mund ta diskutojmë, edhe e shohim nëse nuk është shuma e madhe e mjeteve mund ta shtimë edhe atë projekt në propozimet të cilat mund të realizohen në këtë vit. Faleminderit!

Artan Loshaj: Zotni kryetar, s'pata me dalë, por diskutimi yt më nxiti me diskutue edhe me kolegën diçka në qoftë se ka mundësi mas seancës m'i diskutue. Unë po due rreth propozim-

vendimit, ti thaje që afër 500 mijë euro kemi nda subvencione të vitit të kaluar, po këto janë 250 mijë shtesë. Po due me e ditë qetu në shërbimet kulturore, është 30 mijë euro, a janë shtesë këto, ma tepër se që kemi nda, apo çka, unë këtë s'po e kuptoj. Administrata e arsimit, subvencione 30 mijë euro, kush do të subvencionohet në administratë. Ma herët thaje që keni nda mjete se keni bo projekte dyvjeçare, neve si PDK na keni akuzue me atë raportin e juaj që nuk keni mund me punue shumë mirë, se ju kanë pengue projektet dy-tri vjeçare. Tash e diskutojmë në seancën tjetër. Mos është pak e tepërt, kryetar, qaty kah Bresana, je bo pak si lokalist, afër 57 mijë euro, edhe kryetari Shabani ka ngreh bajagi kah Bresana, edhe ti, diqysh... unë e di që jeni lokalista, veç lokalista pak ma tepër se që duhet. Edhe te 56 mijë eurot për Shëndetësi, ti tash e ndërrove bisedën, se këtu po shkruan blerja e automjeteve për QKMF-në. Okej, shumë në rregull, tash thaje që duhet me ble ni autobus a po? Ni premtim i juaji, i DKA-së, edhe që ka qenë në plan për 2023-tën, ka qenë që fëmijët – nuk jam kundra minoritetit, duhet me i përkrahë, se janë pak, edhe janë çdo ditë e ma pak – po këta që prej mas luftës udhëtojnë pa pagesë, plus hargjimet e rrugëtimit edhe autobusët e këto i blini. Në rregull, edhe ishalla keni pare, edhe ishalla kemi pare, se hala ma shumë duhet me dhonë përkrahje. Po na, ni premtim u juaji edhe ni kërkesë e jemja u konë që këtë vit e keni pas në plan që fëmijëve të shumicës, se edhe ata kanë mbet pakicë, vitin e parë me jau pague 50% të rrugëtimit, ndërsa vitin e e dytë edhe të tretë, deri në fund të mandatit, do ta boni pa pagesë edhe udhëtimin e fëmijëve tanë prej Zaplluxhes deri në Dragash, e prej Pllajnikut e në Dragash. Kjo u konë ni premtim i juaji, për arsye se, e dini shumë mirë që bileta e autobusit është e njëjta gati me Prizrenin, edhe fëmijët tanë sidomos nga Opoja ku vijnë, ni autobus vjen për në Dragash, pesë autobusa shkojnë për në Prizren. Edhe na keni akuzue katër vite ju këtu, edhe me qeto akuzat e juaja s'po merrni masa. Do të diskutojmë edhe në planin e Drejtorisë së Arsimit, është mirë me nda pare edhe me fillue fëmijëve tanë, për këtë vit, së paku 50% me jau pague biletat, edhe për vitin e ardhshëm në shtator kur të vjen, me pague qind për qind se, prej 500 nxënësve kanë mbet 200 nxënës kryetar, e në shtator kemi me mbet me 50 nxënës, edhe fëmijët tanë shkuan në Prizren, arsimtarët e profesorët tanë mbetën pa nxënës. Ju faleminderit!

Munir Jonuzi: E di që kolegu Artani nuk më ka përmendur personalisht, por po bëj thirrje për një përgjigje sepse ka folur për komunitetin joshumicë dhe autobusin që duhet blerë për studentët e komunitetit jo shumicë. Nëse i shikojmë këto investime kapitale dhe veçojmë drejtorinë e arsimit dhe shëndetësisë, sepse janë projekte të përbashkëta, a e keni parë përqindjen në investime kapitale mes komuniteteve shumicë dhe joshumicë. Më lejoni t'ju them, afërsisht midis 75% dhe 25%.

Thjesht nuk e di pse ai autobus është blerë si pjesë e shëndetësisë dhe jo si pjesë e arsimit apo administratës. Por fondet janë sigurisht nga komuniteti jo-shumicë. Nga ato fonde që me ligj i takojnë komunitetit joshumicë sipas shpërndarjes Fair-Share. Nuk janë fonde të përbashkëta. Dhe nëse thua se ai autobus do të përdoret edhe nga fëmijët e komunitetit shumicë kur duhet të shkojnë në praktikë në Prizren.

Uran Halimi: 30 sekonda replikë Artan Loshaj.

Artan Loshaj: Zoti Munir, edhe mu po më vjen çudi pse prej Drejtoratit të Shëndetësisë blihet autobusi për Drejtoratin e Arsimit. Unë nuk jam kundër komunitetit, unë të thash e përkrahi dhe i kemi përkrah si PDK, edhe do t'i përkrahim, po nashta përkthimi të ka ardhë gabim, ose unë po foli pak shpejt e s'po më kupton. Unë e përkrahi iniciativën, edhe jem edhe me ju dhonë shtesa fëmijëve veç me ardhë në shkollë me pare. Unë i thash është mirë, mirëpo është problemi që po duhet edhe fëmijëve tanë me iu dhonë. Nuk jam kundra fëmijëve të juaj, absolut kësi ndasi nuk bon Artani. Se Artani ma shumë jeton me minoritetin, sa që jetojsh ti. Mos më keqkupto, ose në përkthim diçka është gabim. Nuk kesh unë kundra, unë jam për, po problemi është pse premtimi i DKA-së ka qenë që në vitin 2023, në vitin e parë, 50% të fëmijëve të komunitetit shumicë do t'iu bohet pagesa për me iu zbut gjendjen ekonomike, një. Për mos me ik fëmijët me shkue në Prizren, dy. Dhe premtimi ka qenë i DKA-së bashkë me kryetarin e Komunës që deri në mandatin e tyre katërvjeçar, fëmijët e komunitetit shumicë do të lirohen nga pagesa për me ardhë në shkollë, për me mund m'i josh fëmijët tanë këtu, se fëmijët tanë 70% shkuan në Prizren. A sa për ndarjen e buxhetit 75/25, ato ju dy, qysh e keni bo koalicionin, merrnu vesh VAKAT-i me LDK-në.

Uran Halimi: Faleminderit, Artan! E ka kërkue fjalën kryetari.

Bexhet Xheladini: Artan, unë të thash edhe në fillim, m'doket se nuk po dëgjojsh. Në shëndetësi janë nda mjete me buxhetin e vitit të kaluar 25 mijë euro. Tash këto mjete nuk janë të shëndetësisë, që i kemi qit edhe 56 mijë euro, këto mjete janë të Komunës, po duhet me i bashkue, e kemi bo bashkimin e mjeteve, këto mjetet i kemi qit në Drejtoratin e Shëndetësisë, edhe i kemi bashkue. Është bo bashkimi i mjeteve, ti duhet me e kuptue. Sa i përket transportit të nxënësave, ndoshta nuk kie të dhëna, na jemi duke e bërë transportin e nxënësave, të shkollës fillore vetëm e kemi krye, tash është në proces i shkollës së mesme, edhe jo 50%, po jau pagujmë qind për qind, edhe deri në fund të mandatit jo, po deri në vitin e dytë të qeverisjes na këtë punë do ta përfundojmë, edhe do të vazhdoje, edhe është në vazhdim e sipër, nxënësat e shkollës fillore jemi duke e bërë

transportin falas. Edhe për transportin e nxënësve të shkollës së mesme është tenderi i hapur, vetëm pritet konkurimi i kompanive të interesume, edhe këtë vit, masi jemi vonue, kemi vendos me jau pague qind për qind, biletën do t'jau paguajmë qind për qind. Sa i përket investimeve kapitale për komunitetin joshumicë, unë po të garantoj, i nderuar deputet, se investimet kapitale për komunitetin joshumicë e kanë tejkalue 41.3%-shin, janë ma shumë se 41.3%. Nëse dikush nuk beson, mund ta formojë ni komision nga Kuvendi, edhe ta vërtetojë këtë.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti kryetar! Unë besoj që për këtë pikë na kemi me pas mundësi edhe nesër me diskutue. Okej, edhe ni minutë e ka kërkuë fjalën Muniri, po nesër na kemi hapësirë për me diskutue këtë pikë.

Munir Jonuzi: Kryetar, po ta llogarisim buxhetin që kemi miratuar në shtator dhe këtë me të hyrat tona, atëherë realisht ka kaluar 41%. Por çfarë morëm në shtator pse po na e merr tani. Tani po flasim për të ardhurat vetanake. Tani nuk është 40% deri në 60% tani është midis 75% dhe 25%. Nuk po flas për të gjithë buxhetin, por vetëm për këtë. Hidhini një sy, ju keni 10 mijë ne fsh. Radeshë, 8 mijë në Globoçicë, mendoj se 7 mijë në Rapqe, janë 24 mijë gjithsej. Shikoni pjesën Opojes 90 e disa mijëra euro.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Jonuzi! Unë po besoj që kjo është ni bartje e mjeteve, s'po besoj që është ma e rëndësishme ndarja e këtij buxheti, sa është me rëndësi mos me e lonë me u shpenzue kot, ose me na shkue në suficit. Sidoqoftë, na mundim me diskutue edhe nesër. Po vazhdojmë, kush është pro këtij vendimi për bartjen e mjeteve vetanake, e hedhim në votim. Kush është kundër bartjes së mjeteve? Abstenim? Atëherë i kemi katër vota pro, një kundër edhe dy abstenime. Vazhdojmë nesër këtë diskutim, se po e shoh që ka ende paqartësi, ose nashta ka edhe ndonjë ndryshim për të mirë, propozim për ndryshim të mirë të ndarjes së këtij buxheti. Vazhdojmë me pikën e tretë, e kemi raportin e punës së KKSB-së për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2022. Nëse do me e marrë fjalën dikush në lidhje me këtë raport. Nëse jo, vazhdojmë me pikën e katërt, është raporti i punës së ekzekutivit për vitin 2022. Qetash është fjala, Artan, me folë për qeto që fole parës. Nëse do me e marrë fjalën dikush në lidhje me raportin e punës së ekzekutivit për vitin 2022, edhe plani i punës për vitin 2023. Që është volum i madh, ajo veç po shihet, unë u habita kur më erdh materiali, u konë pak problem me hi në çdo detaj. Artan, mundish me i shtue ja dy fjalë.

Artan Loshaj: Kryesues, para se me ia nis, unë po çuditë me ty që pse ti je çudit për raportin, se ti e nënshkrun këtë. Të lutem mos më ndërhyjë tash, replikë bojsh masnej. Unë po çuditë me,

thash edhe ni herë, me ty, pse ti po çuditesh për raportin, se unë sa po të shoh ti veç je këtu sa me na majt në rend, se për rend dite për send e di që s'të pyesin, po me vjen se si me zor po dësh me iu hy nën lëkurë, po problem e kje, s'të marrin këta. Kryetar, në raportin edhe planin e punës tëndin edhe të drejtorive tua, thash edhe ma herët, është shumë voluminoz, deshta me protestue sot mos me folë, po kur e pashë pagën që më ka dalë 800 euro, thash hajt ta arsyetoj, qytetarët bare thojnë ka marrë rrogë të mdhaja...jo shumë mirë, qetash mora nifarë energjie, nifarë vullneti me diskutue. E nisim me raportin e punës së kryetarit. Kryetar, raportin e kje të mirë, po nja dy-tri vërejtje të vogla i kam, për shembull, kur e keni shkruar këtu "është siguruar një ambient i qetë, tolerant, demokratik dhe bashkëpunues në mes të drejtorive dhe stafit". Kryetar, qeto e ke gjet bre, se ambient i qetë u konë edhe me PDK-në... mirë, e qeto deshta me të qit me thonë që e kam marrë copy-paste, a din, me të thonë ti s'e kishe pranue, e deshta me të pru qetu që e ke marrë, se ja Shabani u konë i butë me drejtorët, ja Shabani u konë i butë me stafin, se ma shumë rrinë të Meka se që rrinë në punë, domethënë këtë e ke trashëfue prej PDK-së, se qeta drejtora i kje, qeta punëtorë i kje, jeni ndërrue ja dy-tre vetë. Urani ka ardhë, ti edhe tre-katër drejtora të tu, nënkryetari. Tjetër: "organet komunale janë angazhuar fuqishëm në rritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale, si ato administrative, po ashtu edhe shërbimet e furnizimit siç është uji i pijshëm". Qet ujin e pijshëm, s'pe di për cilin ujë e ke pas fjalën. Okej, mirë shumë, në rregull, qeto veç deshta se s'e pata të qartë ku, me pas shkruar në kllapa "uji i Dragashit", nuk kishom bo debat. E krewa, faleminderit. "Buxheti i aprovuar për vitin 2022 është realizuar 95%", edhe e keni ngrit këtë udhëheqjen në qiell, po prit një troh, se me qeta punëtorë të administratës, me qeta punëtorë të urbanizmit, të prokurimit, me qeta kemi punue edhe na. Prit një troh, 95% ke bo mirë shumë që e ke realizue, se i fitojmë subvencionet prej...grantin qeveritar, po për efikasitetin edhe për cilësinë mos u ngut. Le t'bjerr ni borë e parë, atë rrugën në Restelicë që e keni bo atë ditë, me traktora e keni hek borën masnej e keni shtrur asfaltin natën, prit ni troh, se mas gjashtë muaje ata dalin, dalin se kanë dalë edhe te na ato, ja dy vjet mos u ngut. E di që e kje vitin e parë, që dësh pak me iu dhonë energji pozitive punëtorëve, po nuk dhezin ata punëtorët se janë të PDK-së, kryetar. Urbanizmi, prokurimi, qata janë. Nuk dhezin ata se janë dizellasha, në t'shtyme s'e kanë ata. Eh, qetu e pashë: "është bërë një punë kualitative dhe e qëndrueshme", e thash këtë. Ma shumë me ty – se si kryetar je shumë kështu simpatik – s'po due me hi, ke bo kështu disa mbështetje, disa kërkesa, disa memorandume, ke mbështet edhe me pare, shumë në rregull, veç në faqen e fundit, parafundit, 25 edhe 26 me numër, "kontratë për ndarjen e mjeteve financiare Komuna e Dragashit

- OJQ 'Qendra' “, nuk e ke qit shumën sa. A është bo ndonjë lëshim, ose është ndonjë fshehje e kësaj. Mirë, s'po ta marr për të keq, se ka mund kompjuteri mos me e pranue, nuk ka shifër. Këtu, për shembull, “kontratë për ndarjen e mjeteve financiare Komuna e Dragashit – Fidani”, 3,300. Këtë 'Qendrën' s'e ke bo, edhe ma poshtë, 26-shi, “kontratë për ndarjen e mjeteve financiare Komuna e Dragashit – OJQ 'Demokratska Omladina Gore'”, edhe për këtu s'është shuma, po për hir të transparencës është mirë shumën me e qit, a 1000 a 3000 a 5000. Për ndesër në qoftë se ka mundësi. Mirë, faleminderit shumë! Qekjo ke e jotja, se i kam nda ka njo ka njo, se ato 500 faqe kur po marr me i asi, po më ik faqja, apert po duhet me ia nis prej fillimit, deri po e gjoj po më hup vaket. Te Drejtoria e Financave, unë nuk jam ekonomist, nesër e kemi asambleistin tonë që diskuton me drejtorin, se nuk hi shumë se s'di, veç po due me e pyt qet raportin që e ka bo drejtori, personat që kanë shlyer borxhin kongan konë 20 vetë, personat që nuk kanë dalë fare për shlyerjen e borxheve kongan 39, domethënë afër 70%. Sefidini qetu e mbrojti drejtorin, nashta ju kujtohet, se memorien e kam shumë të freskët, kur e mbrojti tha shumica e kanë bo pagesën. Edhe nuk e ka shkruar qetu në raport qato paret e përmbaruesit, që i ka dhonë, që i ka çue lëndët, 67 edhe që i ka kthye prapë, sa pare i ka dhonë, është dashtë për hir të transparencës me e shkruar 200, 300, m'erdh se m'ka thonë 460 euro ka bo nifarë hargjimi, nifarë dëmi Komunës, drejtori i Financave, me e pas shkruar në raport, me thonë që 460 euro i kam bo edhe unë dëm, me e pranue ni realitet, kam gabue, s'kam ditë, i kam bon ja 500 euro dëm Komunës, me e ditë qytetarët, jo për mu, se unë i di krejta. Raporti i Punës së Drejtorisë së Administratës, edhe këtu në administratë është copy-paste i joni, veç ni pyetje deshta me bo, ty si kryetar edhe nesër drejtorit. Plani i Punës së Prokurimit, me ligj është – këtu e kemi edhe OSBE-në, s'di a kemi të drejtë me ia dhonë fjalën me na dhonë sqarime – që Plani i Punës së Prokurimit duhet të plotësohet edhe të vjen të miratohet në Kuvend, deri në fund të muajit shkurt. Unë nuk e pashë në plan të vitit 2023, edhe muajin e kaluar në plan të Kuvendit Komunal nuk e kem pas shqyrtimin e Planit të Prokurimit. Domethënë, edhe ni herë të jem ma i qartë, Plani i Prokurimit duhet të përpilohet nga ju, nga Kuvendi Komunal, dhe të bihet të debatohet, të miratohet në Kuvend, për investimet që do të vijnë në vitin 2023 edhe ajo është – kemi qenë nëpër seminare na, jemi konë me Xhemilen, jemi konë me Munirin - e kemi deri në fund të muajit shkurt. Është mirë që me e përgatit këtë muajin, e bare në fund të muajit mars me e pas si plan edhe me votue, për investime.

Raporti i shëndetësisë, eh këtu kemi pak çka me diskutue. Veç të shohim kah me ia nis niherë faqes, se po shkoj po i harlisi. Kryetar, sefte, s'po mundi me e kuptue unë qet raport edhe qet plan

të punës. A është raport a është plan. “Sektori i shëndetësisë, qëllimet e përgjithshme”, është copy edhe raporti edhe plani. Domethënë ky është i padijshëm për shëndetësi, aftësinë e ka shumë të kufizuet, është i padëgjueshëm, është i pariparueshëm se s’pyet ai, as nuk di as nuk konsultohet. Me asnjë takim zyrtar – se jam punëtor aty – nuk shkon në Prishtinë absolut. Ndoshta e merr kerrin te ju, e bon ni kërkesë, po nëpër takime nuk shkon, se e pyesim, nuk ka përgjigje. Domethënë me ni plan të punës, veç me ni faqe, gjithë ajo shëndetësi, është vallahe për më të ardhë keq, se është gjynah i madh. S’po e kuptoj unë këtë drejtorin, sa herë po i thom, po më vjen se po merr gaca edhe ma shumë po dhezet, edhe ma shumë p’e bon kokëfortësinë. Është drejtor për me të ardhë çudi. Edhe, po shkojmë ma detalisht po himë pak. Jo, jo për nesër se s’un i mbërrij nesër, se duhet me ju përgatit për nesër pak. E ka bo qetu “inspektimi i qendrave private shëndetësore”. Qendra private shëndetësore i ka – ta përgatiti pak për nesër, se s’di çka me m’thonë, bare sot ia kallxoni, e nesër ja dy-tri fjalë m’i kthen - inspektimi i qendrave private, unë s’pe di sa qendra private ka. Janë ja dy a tri, njo prej tyne kryetar je ti. Unë s’e di a u konë te kryetari me bo inspektim, është marre në qoftë se s’u konë mos ta shkruajë. Se ni inspektor i Komunës, kryetarit s’shkon me i bo inspektim, mos t’shkruj se qetor privatizëm nuk ka këtu, është doktor Musa edhe je ti. Domethënë, mos të shkruen veç m’i mbush dy-tri faqe. Edhe “zhvillimi i një plani akomodimi për territorin e Komunës”, s’pe kuptoj. I planit të akomodimit nuk p’e di çka p’i bjer. Këtu te arritjet, ta shohim ku i kemi. Organizimin, mos ta diskutojmë se është për me të ardhë keq. Arritjet ku i ke bo këtu, “modernizimi i pajisjeve shëndetësore”, hora e zezë kryetar, hora e zezë. Kurgjo s’ka pru hiç. Nuk ka mjete higjienike, nuk ka shampon për duar, nuk ka palloma, është për me të ardhë keq. Pastërtia është jo zero, nën zero. Je konë edhe vetë, unë s’e di qysh mundni me i pranue qeto, edhe qysh me mund me ia pranue këtij në raport. Nuk po shoh në plan që ka me bo atë. Unë nuk e pashë në plan këtu, për shembull, me e rrit cilësinë në punë. E vetmja QKMF – se dola prej kontekstit, se shumë kam me fol, nesër mo, se dola taktit pak – e vetmja QKMF që nuk ka radiolog jemi na. Ta kam thonë edhe herën e parë. A s’e keni bo plan për shembull në vitin 2023, se shëndetësinë ky drejtor e ka pru para kolapsit. Edhe tri vjet mandat ky sa i ka, tamam shëndetësia shkon në kolaps, dhe mas tri vjete fjalët e mia evidentohen, fjalimet e mia evidentohen, është kafshatë që s’kapërdihet, dy mjekë nuk kanë me të mbet qetu. Është marre, ni plan, katër vjet drejtor u konë edhe dy vjet me ty gjashtë, me bo ni plan m’i çue dy mjekë në specializim, me çue ni radiolog në specializim. Po keshesh kryetar, se na keni akuzue edhe në kauzën e shëndetësisë që kemi bo gabime, keni ardhë ju në pushtet, veç po vazhdoni me të njëjtin drejtor. E vetmja QKMF, të thash

edhe ni herë, radiolog që nuk ka. Shkojsh e bojsh një rëntgen, CD-en ta bjer ty edhe e lexojsh, ose ni mjeku të ri. E vetmja QKMF në Kosovë edhe në botë që nuk ka biokimist, kryetar. A s'keni bo plan, hajt Shabani s'ka ditë kryetari, edhe Salimi u konë bujk s'ka ditë, po ti si kryetar me bo planifikim për katër vjet m'i çue ja dy mjekë bre në specializim. Ke marrë mjekë, ke pru mjekë të lëmive tjera, shumë mirë ke bo. Pse nuk e keni bo plan me pru edhe ni gjinekolog, masi keni pru specialist. Edhe i keni pru dy specialist, unë të thash edhe ni herë, ke bo shumë mirë që i ke pru, po pse s'e ke pru edhe ni specialist të gjinekologjisë që është shumë ma e nevojshme, edhe me statut të QKMF-së kemi të drejtë me pas pediatër, gjinekolog, radiolog edhe biokimist. Nuk kemi të drejtë me pas neurolog, neuropsikatër edhe oftamolog. I ke pru, faleminderit shumë, në emër të qytetarëve, se po bojnë vizita. Pse nuk bini edhe gjinekolog, pse nuk e bini, është nashta turp me e përmend, por po e përmendi për të mirë, qe doktor Fehmin ku e kemi, masi janë pensionera ata. Kuadër deficitar, doktor Fehmia 40 vje i ka shërbye këtij vendi. Doktor Fehmia është këtu, edhe me e marrë doktor Fehmin me e pru në punë, se ka nevojë edhe jau di ma mirë qytetarëve. Edhe, masi jemi qetu mos po harroj, a ka mundësi me na shpjegue sa e kanë pagën këta dy mjekët, edhe sa e kanë kontratën, a e kanë gjashtëmujorë, a njëvjeçare a trivjeçare, me e ditë. Edhe due m'u kyç te seanca e kalume, se unë ika pak ma herët, e kam pas ni punë. Sefidini kur të nxiti ty me dalë me replikue për reagimin e PDK-së që e ka bo për dy mjekët edhe për doktoreshën. Atë ditë unë nuk kesh në seancë me të bo replikë, se PDK-i këta tjerët s'folin. Mos m'u konë unë mshelni edhe... po due me të pyt ni send unë, shumë mirë ke bo për doktoreshën që e ke marrë me konkurs, çka ke ajo e doktor Selamisë diçka, se s'pe di, ke bo shumë mirë që e ke marrë, të përgëzoh për këtë, po është mirë bre kryetar ni herë në muaj t'ia shohim bare fytyrën asaj, se në çdo vend në Republikën e Kosovës, në specializim kur shkojnë, ni herë ose dy herë në muaj vijnë e japin ni kujdestari. Është mirë ajo doktoresha bare ni herë në muaj, ni të premte me ardhë, masi me konkurs e ke marrë. Unë e di, ajo e ka marrë specializimin prej asaj private, po masnej për jarani, për shoqëni, e ke pru me konkurs të QKMF-it. Në qoftë se është punëtore e QKMF-së, e ka obligative minimum ni herë në muaj me ardhë ajo me dhonë kujdestari, me e pa na qytetarët, m'u mësue me rrethin, m'u mësue me shoqëninë, m'u mësue me punëtorët, m'u mësue edhe qytetarët me thonë qy qekjo doktoresha e re ka specializim, ka me ardhë, e qe po vjen e e mira, e për me i fitue edhe ni parë zgjedhje ju e kam, se për mu s'o problem, unë apert i fitoj për vete. Domethënë është mirë, thash edhe ni herë, me na kallxue...okej, unë po të shoh që je i revoltuet pak, po unë e bona ni pyetje pa të keqe kështu, me e ditë që, kallxo me ni vend në Republikën e Kosovës...po unë kam

të drejtë me pyet, ti kie të drejtë mos me dhonë përgjigje, unë po të pyes ty si kryetar, më kallxo sa e kanë... a kam të drejtë me pyet sa e kanë pagën specialistat? Po, kam të drejtë me pyet. Edhe a kam të drejtë me pyet sa muaj kanë kontratë me ty, a kanë gjashtë muaj, a ni vjet pesë vjet a. Ju për transparencë po thoni jemi shumë transparentë. Hajt na kallxoni sa e ka pagën mujore ni mjek që vjen në vizitë ni herë në javë, shumë thjesht po të pyes. Edhe po të pyes shumë thjesht a keni në plan të 2023-ës me çue mjekë specialista, kurgjo s'po të pyes unë të keqe, personale s'e kom kurgjo me ty, të respektoj sa të duesh, jashtë kësaj edhe në shpinë sit ë duesh të bari, po kështu qytetarët po pyesin, qaj doktori që po vijke bre sa paguhet, vallahe e pyes kryetarin e ju kallxoj. Sa e ka kontratën, unë s'po thom...kurgjo s'jem t'o të thonë unë. Kryetar, gjendja në pediatri, e dini, edhe ni herë e kam diskutue, është e mjerueshme, a po? Keni thonë që brenda një muaji, dy, ato që po pikën, që edhe asambleistja kur ka qenë me fëmijën e vet edhe nuk ka pas ku me ndërrue edhe fëmijën e vet, pediatria nuk të punon kryetar, tash edhe farmacinë e ke çue poshtë, vend kemi, krejt pediatri në kemi vend sa të duesh, ni fëmijë, ni nënë lehonë me fëmijë shkon në pediatri në katin e dytë. Edhe në pediatri rrinë me pacientët e tjerë që janë të sëmurë kronikë. Sot është edhe virusi, ti e dish ma mirë, je specialist, ni fëmijë njëmuajsh rri pret rend dy orë, bon vaki edhe tri orë, ni ultrazë punon, doktoresha punon, doktori punon, punon pediatri. Prej katit të parë shkojnë në katin e tretë me bo ultrazë, prej katit të tretë vijnë në kat të dytë me bo vizitën specialistike, prej katit të dytë zhdrypin në kat të parë me e marrë vaksinën. Ti e dish shumë mirë kryetar, ata kur e kanë ndërtue QKMF-në, e kanë bo hyrjen veç, as mos me pas kontakt ni fëmijë i posalindur me pas kontakt me të sëmurit kronikë, me të sëmurit infektivë. Qe tash kie mundësi. Thash edhe herën e parë, po të thom edhe sot, rrogat tash që na kanë dalë edhe koeficientët na kanë caktue, rrezikshmërinë në punë edhe me i nda, me i kualifikue infermierët me shkollë të mesme edhe me fakultet. Është mirë m'i thonë edhe drejtorit të Shëndetësisë, këtë muaj deri me të 10-tin me i përgatit kontratat e reja, edhe muajin tjetër ata që kanë bachelor edhe ata që kanë rrezikshmëri le të dallojnë prej të tjerëve, se i ka dallue qeveria, është mirë me i dallue edhe komuna. Domethënë, thash edhe herën e parë, nuk mora përgjigje. Është mirë këto ditë me diskutue ti, me na bo kontratat e reja kush ka nivel ma të naltë në shëndetësi edhe kush ka rrezikshmëri. Nuk munden ni infermier që punon në urgjencë ose që punon në rëntgen, m'u kon i kategorizuet me ni infermier që punon në kartotekë, nuk po i akuzoj unë ata që s'po punojnë, po vendi i punës ta cakton rrezikshmërinë. Domethënë është mirë me u marrë me këto, a sa për diskutimet që po i boj unë edhe që po

hidhëronu, unë s'kam faj se unë qet punë e kom. Unë jem opozitë edhe m'i gjet gabimet e juaja, se kur i gjë opozita gabimet ju përmirësonu edhe bonu ma efikas edhe...faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Loshaj! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Më duhet ti tregoj Kryetarit disda gjëra që ai ndoshta e di se ekzistojnë. Ne kemi pesë qendra të mjekësisë familjare në komunën tonë, një nga ato qendra është qendra e mjekësisë familjare në fshatin Rapçë, ku vetëm një teknik mjekësor është i punësuar vazhdimisht, herë pas here kemi mjekë që vijnë dhe kjo ndodh një herë ose dy herë në javë. Ne e dimë që në bazë të ligjit qendra e mjekësisë familjare duhet të ketë shtatë punonjës, se kemi teknikë, mjekë, stomatologë etj. Këtë problem e kam theksuar edhe në mandatin e kaluar. Ndërsa ne nuk kemi as punëtorë ndihmës në këtë situatë. E kisha fjalën për faktin që vetë punonjësit e shëndetësisë e mbajnë qendrën e mjekësisë familjare. Shpresoj se në periudhën e ardhshme do të bëhet diçka për këtë çështje. Kolegu Edin vuri në dukje një gjë, se versionin elektronik nuk përputhet me versionin e printuar. Unë si një person që nuk i shikoj kurrë versionet e printuara, fola pak më parë për buxhetin, për të ardhurat e mia, për konsumin, pyetja ime është pse këto dy versione janë të ndryshme. Pse kemi një ndryshim midis versioneve elektronike dhe atyre të printuara? Si është e mundur. Si u bë. Për shembull, administrimi 4000 euro, nuk e kemi në versionin elektronik. Nuk kemi asfaltimin e rrugës Zlipotok-Globoçicë-Baqkë, nuk kemi shumë gjëra në versionin elektronik. Pse versionin elektronik duhet të jetë i ndryshëm nga versioni i printuar? Dua të theksoj një gabim teknik, kur flitej për bashkëfinancimin e zyrës së Kryetarit me organizatën humanitare “Jetimet e Ballkanit”, shkruhej se kemi marrë pjesë me 40 mijë euro, ndërsa kemi marrë pjesë me 30 mijë euro. Ndoshta është shtuar diçka, por unë nuk jam në dijeni të kësaj. Mendoj se është një gabim teknik që duhet korrigjuar.

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Jonuzi! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Unë veç deshta m'u ndërlihdë te ni fjalim paraprak, te raporti, është fjala për këtë raportin këtu që e kemi të punës së ekzekutivit, unë nuk e nënshkruaj raportin e punës së ekzekutivit, unë e nënshkruaj vetëm vendime të Kuvendit, qe ky raporti nuk është i nënshkrum prej meje, edhe s'muj me e ditë komplet, se as s'e kam përpilue unë këtë raport. Mandej, sa i përket stafit të kryetarit, unë s'jam pjesë e stafit të kryetarit, unë jam legjislacioni, s'kam të boj me stafin e kryetarit, domethënë, kryetari edhe ekzekutivi dallojnë krejt prej neve këtu që jemi në Kuvend. Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Atëherë vazhdojmë me votimin e pikës së katërt të rendit të ditës, kush është pro raportit

të punës së ekzekutivit për vitin 2022 edhe planin e punës për vitin 2023? Pra, kush është pro që të kalojë nesër në seancë, është puna pro...nesër e shohim kush është pro edhe kundër. Kush është kundër këtij raporti? Abstenim? Katër vota pro, ni kundër edhe dy abstenim, kalon ky plan i punës për vitin 2023. E kemi pikën e fundit, eventualen. Nëse do dikush...në rregull, para se të kalojmë te eventuale i kemi disa kërkesa nga qytetarë të Komunës së Dragashit. E kemi Almir Ibrahimimi, i cili ka kërkuar që Komiteti me ia sigurojë ni karrocë, e cila mban vlerën diku deri në 1800 euro. Mandej kërkesa tjetër është e shëndetësisë patjetër, është Ymihane Çengaj, unë po besoj që është mirë na me e lexue të paktën kërkesën...në rregull, kryetari po kërkon, t'i përmendi veç emrat e kërkesave kryetar, edhe mandej e marrish fjalën. Është Ymihane Çengaj nga fshati Pllajnik, e diagnostifikuar me tumor, tjetërkënd e kemi Fuat Kryeziu, është fjala për bashkëshorten e tij, sëmundja...s'pe kuptoj unë, domethënë është kancer edhe ky i gjirit. Edhe e kemi kërkesën e katërt edhe të fundit, është Selvishah Mehmeti nga fshati Zaplluxhe, edhe kjo me një diagnozë hepatis...s'pe kuptoj, edhe kjo është, kanë bo kërkesa për ndihma financiare. E ftoj kryetarin që ta marrë fjalën, pastaj do të diskutojmë nëse është e nevojshme për secilën.

Bexhet Xheladini: Deshta Artanit t'i përgjigjem lidhur me rrezikshmërinë në punë. Na dje bashkë me stafin jemi marrë me këtë çështje, sigurisht të kanë njoftue, edhe e dish, e për atë po i paraqet do gjona që ke dëgjue që i planifikojmë me i bo, edhe tash po paraqitesh, po i bojsh si kërkesa, në mënyrë që kur të bohen ato me thonë populli që vallahe Artani e dha propozimin edhe kjo u realizue. Je bo copy-paste e një personi tjetër që ma herët qeshtu ka bo. Edhe unë kam respekt, po dëgjo! Dëgjo, unë atë çka e thom është e vërtetë. Ani mos tolero, puna jote është. Jo, s'të kam bo ofendim. Okej, atëherë po kalojmë tash në këto kërkesat, se kërkesa e Almir Ibrahimit i është drejtue edhe zyrës së Komuniteteve, edhe mirë është për këtë kërkesë KPF të vendosë, të konsultohna edhe me zyrën për Komunitete, edhe në seancën tjetër të KPF-së ta marrim ni qëndrim, se kjo është edhe çështje të cilën mund me e vendos Komiteti. Po të shohim nëse ka mundësi zyra e Komuniteteve përmes donatorëve të ndryshëm t'ia sigurojë karrocën këtij personi, për arsye se e njoh këtë, është vërtet në gjendje ashtu qysh e ka përshkrue, atëherë na mujm edhe si Komitet, mundeni ju si Komitet me nda mjete. Sa i përket këtyre tri kërkesave tjera, të gjitha janë kërkesa të cilat kërkojnë ndihmë financiare për shkak të sëmundjes. Unë ju kisha propozue që këto t'i drejtohen zyrës së Kryetarit, na edhe vitin e kaluem kemi nda mjete financiare për njerëz të sëmurë, sidomos ata që janë me kancer, edhe na sigurisht që edhe për këto raste do të vendosim edhe do të ndajmë mjete, mirëpo këtë disa persona janë mësue, e dinë që KPF mund të ndajë ma

shumë mjete, edhe për atë ju janë drejtue edhe juve, po megjithatë, nëse na i shpenzojmë mjetet, edhe disave iu ndajmë ma shumë e disa të tjerëve të cilët janë të barabartë me këta edhe i kanë sëmundjet e njëjta, atëherë mund t'u hymë në hak atyre, të shpenzohen mjete edhe mos të marrin. Propozimi im është që këto tri kërkesa t'i kalojnë zyrës së Kryetarit, edhe prej subvencioneve të kryetarit, siç do t'iu ndajmë të gjithëve për sëmundje të kancerit, do t'iu ndajmë edhe këtyre personave.

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Deshta me shtue diçka edhe mandej po jau jap fjalën. Unë nuk e di, na zakonisht kemi bo, kemi delegue kërkesa prej Komitetit për te zyra e Kryetarit, po nuk kam pa ndonjë raport sa janë marrë parasysht ato që i kemi dërgue ma herët. Atëherë i kontrolloj në raport, edhe është mirë, nëse është diçka që vërtet bohet edhe nuk lihen anash, s'është problem. Fjalën e ka kërkuë Artan Loshaj, pas tij zoti Edin Kurt.

Artan Loshaj: Kryesues, vërejtje për ty edhe direkt për kryetarin. Kryetar, respekt të madh si i moshuar, respekt të madh si doktor, nuk toleroj, rreth debateve politike mundesh ni javë ditë me ofendue sa të dësh, politikisht rreth debateve, bullizëm me bo edhe me më injorue mu nuk toleroj, po të thom kështu, ma mirë bonu burrë edhe del kërko falje. Nuk toleroj bullizëm me bo, me m'krahase mu me atë, nuk kam ardhë ti mu me m'krahase mu. Mu më ka pru qytetari këtu. Unë të thash, rreth politikës, politikisht, mundesh me m'krahase sa të dësh, me m'thonë p'i marrish informatat e p'i biosh, nuk diskutova, me m'thonë je bo si ai tjetri, burrat kërkojnë falje. Kur e kam bo unë gabimin te ti, kam ardhë publikisht kam kërkuë falje, kryetar a po më falish se kam gabue. Bullizëm edhe injorim, mu krahasim me tjerit nuk toleroj me m'bo. Unë jam faqebardhë, unë të dal në katër sy ku të dësh përpara, mos po të lutem si prind, po të lutem si ma i moshuem, si doktor. Të lutem, vërejtja e fundit, publikisht po të thom, mos më ofendo, nuk të toleroj, nuk toleroj kryetar me m'bo mu si ai tjetri. Politikisht po, mundesh me thonë si Shabani si ai tjetri, se unë vetë i përmendi, ama me m'injorue edhe me bo...mos të lutem, burrat kërkojnë falje. A mundi me vazhdue eventuale a me ardhë edhe ni herë, se qetu e pata replikë?

Uran Halimi: Po ni herë na e kemi m'i qit në votim kërkesat që patëm me ia delegue kryetarit. Nëse është fjala për diskutim në lidhje me këto kërkesat që e keni kërkuë fjalën ti, Edin edhe Munir, mundeni me e marrë fjalën. Nëse keni me diskutue për kërkesat që ia deleguem kryetarit, atëherë mundeni me e marrë fjalën.

Edin Kurt: Pershendetje te gjithëve. Më interesojnë dy gjëra. E para është se sa para ne si Komisioni për Politikë dhe Financa kemi në nivel vjetor për të ndarë për raste të tilla dhe e dyta që më intereson është nëse kërkesa e z. Almir Ibraimi, është nga komunitet i jo-shumicë, duke pasur parasysh që kur kam qenë anëtar i këtij komisioni deri më tani, nuk kemi ndarë mjete për një komunitet joshumicë. Pra, nëse ai është nga komunitet pakicë, nuk do të ishte keq ta ndihmonim këtë njeri.

Uran Halimi: Faleminderit, fjalën e ka zoti Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Zoti Kryesues, nuk kam të drejtë të diskutoj për kërkesat që i janë dërguar kryetarit të komunes. Unë kam të drejtë të diskutoj kërkesat që i janë dërguar komisionit të politikave dhe financave. Z. Edin pyeti nëse zoti Almir është pjesëtar i komunitet joshumicë, po, të gjithë e dimë që, po, shkruhet në dokument. Ai, babai i tij dhe kushëriri i tij kanë pasur një aksident trafiku afër Zhurit vitin e kaluar, të gjitha këto janë deklaruar këtu në atë dokument. A duhet të presim lejen e dikujt për ta ndihmuar këtë njeri, nuk mendoj se duhet. Le ta mbështesim këtë propozim sepse kemi të drejtë të ndajmë deri në 2000 euro. Kjo është një kërkesë për 1800 euro. Dhe në të njëjtën kohë kjo është kërkesa e parë e komunitet joshumicë, le të tregojmë se po shkojmë në drejtimin e duhur dhe ta mbështesim këtë kërkesë.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Jonuzi! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën. Zoti Loshaj e ka kërkuar fjalën. Po po, për qet rastin është fjala.

Artan Loshaj: Edhe unë pajtohem me këto kërkesa, jo për diçka, jo m'i nda minoritetin edhe shumicën, po për hir të sëmundjes, edhe për hir të mundësive që kryetari i Komunës mbi 1000 euro nuk ka të drejtë me dhonë, se nuk jam kundër kryetarit që nuk po do me e bo, po deri në 1000 euro është limiti i kryetarit që mund me dhonë ndihma, domethënë prej 1000-2000 euro jep Komiteti. Kryetari jep deri në 1000 euro. Kërkesa është 1800 euro. E atëherë, në qoftë se edhe e ka vullnetin kryetari me bo këtë pagesë, nuk mund me bo. Atëherë, direkt ky problem i bjer KPF-së. Edhe, unë këtë personin e njoh, është i Dragashit, ka pas aksident, daja edhe baba i kanë vdekur në aksident, ky është i vetëm, veç me nënën edhe me ni fëmijë jetim, edhe gjendjen e ka të rëndë, edhe mjerë ai që është në këtë gjendje. Unë jam për, Komiteti mund me i nda 1800 euro për me e ble këtë karrocën. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Loshaj! Kryetari...veç pak kryetar. Kryetari e ceki që ka bo kërkesë edhe te Zyra e Komuniteteve, nëse Zyra e Komuniteteve nuk mundën me ia sigurue këtë, ose nëse e ka bo të njëjtën kërkesë në dy-tri palë, na është mirë me u koordinue, se nëse na i subvencionojmë me 1800 euro për karrocë, del edhe ni donator ia blen edhe ni karrocë tjetër, edhe automatikisht ky mundën m'i fitue dy karroca, se s'e kthen prapë, se i ka përfitue. Pastaj, unë të paktën qeshtu e kuptova, nëse jo kryetari mundën me na sqarue edhe ni herë, mandej mundeni me e marrë fjalën për replikë secili.

Bexhet Xheladini: Kërkesa e Almir Ibrahimit i është drejtue edhe Zyrës së Komuniteteve dhe KPF-së. Kërkesa e Almir Ibrahimit është e arsyeshme, edhe duhet me i ndihmue, edhe duhet Komiteti me e marrë ni qëndrim pro, ose ju...është puna juaj. Mirëpo, nuk është vonë me prit deri në mbledhjen e marsit, keni me e pas ju edhe ni komitet, na konsultohna me Zyrën e Komuniteteve, edhe ka mundësi që ia gjojmë ndonjë donator, mundën me ia pru atë karrocë. Nëse deri në muajin mars nuk mundet, atëherë Komiteti le të vendos edhe le t'i ndajë këto mjete për blerjen e kësaj karroce. Kjo është, mirëpo mundeni me vendos edhe sot, është punë e juaja, nuk është problem. Po ato mjete nuk janë të Komitetit, po janë të Zyrës së Kryetarit, qato 100 mijë eurot që janë, çka të vendosni ju, ato mjete hiqen prej Zyrës së Kryetarit, minusohen edhe zvogëlohen.

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Ni minutë replikë zotëri Edin Kurt, pas tij fjalën e ka zotëri Munir Jonuzi, me ka ni minutë ju lutem.

Edin Kurt: Faleminderit që më njoftuat, ai aksident automobilistik ishte një tragjedi e madhe për atë familje, kërkoj nga kolegët e mi të mbështesin këtë propozim sot në komisionin tonë për politikë dhe financa. Sa i përket zyrës për komunitete pakicë, unë nuk kam besim në zyrën për komunitete pakicë. Kjo familje është pjesëtare e komunitetit goran, ndërsa z. Uzair Hamza nuk ka treguar mbështetje për komunitetin goran gjatë viteve të fundit, por më shumë për komunitetin boshnjak. Ndaj, për këtë arsye, i kërkoj kolegëve të mi që ta miratojnë këtë kërkesë dhe ta mbështesin këtë familje. Prej sa qe jamë anëtar, e përsëris, është hera e parë që kemi një kërkesë nga një pjesëtar i komunitetit pakicë.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Kurt! Zoti Jonuzi e ka fjalën.

Munir Jonuzi: Z. Kryetar, deri ku keni ndërmend të kërkonit donatorë kur bëhet fjalë për anëtarët e komunitetit jo-shumicë. Deri ku keni ndërmend të angazhoni KFOR-in dhe OSBE-në kur bëhet

fjalë për anëtarët e komunitetit jo-shumicë. A është kjo komuna edhe jonë? Donatorët duhet të sigurojnë fonde për një person tjetër. Fatkeqësisht, ne kemi shumë prej tyre. Pse duhet të presim me muaj që të zgjidhet ky rast kur kemi mundësi ta bëjmë tani. Gjithashtu thamë se do të na njoftohemi me kërkesat që i kemi shqyrtuar vitin e kaluar por nuk na janë zgjidhur për shkak të mjeteve financiare, tani kemi një rast nga komuniteti jo-shumicë dhe menjëherë po kërkoni donatorë. Nëse i kemi mjetet, i kemi, atëherë ka mbaruar. 2 delegatë bënë një mocion dhe ju lutem vendoseni në votim dhe mos komentoni shumë. A e meriton ky njeri ndihmë, po. Dhe atë emergjente. Dhe sa i përket shefit të zyrës, a e ndihmon komunitetin goran, ai ndihmon komunitetin goran, ndoshta edhe komunitetin boshnjak, dhe së fundmi më së shumti komunitetin bullgar.

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Jonuzi! Ni minutë replikë Artani.

Artan Loshaj: Zotni Kurt, më fal, ju lutem bre, mos të bina qaq në nivel të ulët që me ni të sëmure të bojmë politikë, jo goran, jo boshnjak, jo shumica, jo pakica. Është marre për ne të gjithë, po ta thom si punëtor shëndetësor, edhe po ta thom pak si ma i moshuem. Është marre bre me bo politikë me ni invalid, mosni bre se as zgjedhjet s'janë. Ato problemet që i keni, shumicë – pakicë, goranë – boshnjakë, line kancelarinë za zajdnice, po hajde të dalim ta qesim në votim, ta votojmë, t'i miratojmë. Ai zotnia, e shoh përditë unë, se jo që jem ma i mirë se ju ose ma i dhimbshëm se ju, po jetoj në Dragash me to. Çdo ditë e lume, ai del shëtiti me ni kolicë me zor, deri te stadioni ajo rruga ku është, edhe kthehet. Është i vetëm në shpi, veç me nonën edhe me djalin. Mos boni bre politikë, jo Uzairit s'i besoj e jo Uzairit i besoj, e jo me gjet KFOR e jo me gjet OSBE. Ju lutem, bare me të sëmurin, bare me invalida mos të bojmë hajgare.

Uran Halimi: Faleminderit, Artan Loshaj! Unë po due me e marrë fjalën, se pak...okej, të jap kohë, prit veç pak, mas meje. After me, please. Ke fjala për...se është shuma e mjeteve për ndihmë, kryetari i theksoi që na s'kemi mjete si Komitet, po i marrim prej Zyrës së Kryetarit, për qeto deshta m'u përgjigj, e që ma boni pyetjen Edin Kurt. Mandej, pyetja tjetër, Edin Kurt tha që nuk ka besim në Zyrën e Komuniteteve, ajo është çështje e juaja personale, se unë nuk e di a duhet me pas besim a jo. Sa i përket zotit Jonuzi, pak e politizoi situatën, edhe boni kështu nifarë dallimi, kishe ne po bojmë dallime, mirëpo unë shumë qartë e ma në mend kur e kemi subvencionue në KPF shkollën verore, nëse ju kujtohet, unë jam konë skeptik me e subvencionue shkollën verore, edhe kam kërkue informacion sa studentë tanë e kanë ndjek atë shkollën verore, as që e keni përfillë atë. Domethënë, lypni mbështetje aty ku ju konvenon me mbështet, pjesën tjetër e kaloni, sidomos

ju të komiteteve. Na kemi pas kërkesa e kërkesa të ndryshme, qetash shumë mirë, shumë aktiv, po më pëlqen, ty për herë të parë po ta nij zonin zoti Kurt. Shumë po më pëlqen kjo, kurrë s'keni folë, kurrë s'e keni marrë fjalën, e sot e politizoni pak, është goran, s'është i komunitetit e ashtu, këto muhabete te unë nuk dhezin, se për mu janë krejt qytetarët të njëjtë. Jemi Komiteti, e qesim në votim, nëse mendoni që duhet me i subvencionue, ama krejt kemi m'i subvencionue, të katër kërkesat, a po kupton, edhe kur të vijnë kërkesat e radhës kemi m'i trajtue njëjtë qysh p'e trajtoni këtë kërkesën. Se kërkush s'vjen prej qefit këtu me bo kërkesë. Shumë po më pëlqen trajtimi i këtij rastit, ama të gjitha rastet duhet t'i trajtojmë në këtë mënyrë, se kur boja kërkesë unë për numrin e studentave, se ju kujtohet shumë mirë, e dini, kur boja kërkesë unë për numrin e studentave të cilët e ndjekin shkollën verore, se unë kesh skeptik, na po subvencionojmë mjekësi, shumë raste të ndishme, e subvencionuem shkollën verore, pa llogaridhënie, nëse ju kujtohet 2000 euro ia lëshuem na, unë bashkë me ju, unë jam konë, kam abstenuë bile, nëse e dini, në votim. Shkollën verore e subvebcionuem, plotë kërkesa tjera ia kemi delegue kryetarit, sot s'po duhka me ia delegue kryetarit. Po më pëlqen, kemi me qit në votim, s'po diskutojmë mo, kemi me qit në votim, nëse mendoni që duhet m'i subvencionue krejt kërkesat, qetash kemi me votue, këto pako kanë me shkue, jo m'i dallue veç e veç. Jo bre s'ka replikë, u krye mo puna e replikës, dy herë ia dhashë replikë. Domethënë, nëse i subvencionojmë, krejt kërkesat, nëse jo, asnjë. Ju e dini çka vendosni. Po kryetar. E qesim në votim edhe propozimin tem. Okej, okej, e qesim në votim propozimin tem. Prit veç pak, ta shohim kryetari çka po na thotë, Artan.

Bexhet Xheladini: Unë, për me i ndalë replikat, unë ju kisha propozue për kërkesën e Almir Ibrahimit, e njoh personalisht, e di që e ka gjendjen shumë të rëndë, edhe iu myt baba, iu myt edhe daja, edhe e kanë gjendjen ekonomike të keqe, KPF të mos pret pra në muajin mars, le ta merr ni qëndrim, le t'i ndajë mjetet, kurse për tri kërkesat tjera, unë po ju garantoj atyrrë iu ndajmë mjete, po iu ndajmë në mënyrë të barabartë, kush është me kancer i merr...nëse i marrin të gjithë ka 500, të gjithë ka 500 kanë m'i marrë, nëse i marrin ka 300, të gjithë kanë m'i marrë ka 300, jo dikush m'i marrë 2000 e dikush mos me marrë hiç, këtu është problemi. Edhe, këto rastet që i pashë, do të thotë kanë shkue janë operue në spitale private, në spital amerikan, tash ka pas mundësi ai me shkue edhe në spital të shtetit m'u operue. Kështu që mos të bojmë...unë jam mjek vetë, edhe i di rastet, edhe unë thash për humanizëm kam punue tërë jetën, edhe nuk boj dallime as në aspektin nacional, as në aspektin njerëzor, as në aspektin politik. Kështu që rastet të cilët kanë nevojë për m'i ndihmue për sëmundje, unë i ndaj në disa grupe, ata që janë me kancer marrin ni shumë të

caktume të mjeteve, ata të cilët kanë sëmundje kronike, tjetër lartësi e mjeteve është, ata të cilët kanë diabet etj.etj., kështu që mirë është këto tri kërkesat me ia qit kryetarit, tash komisioni ka me u mbledhë, se janë mbledhë mbi 100 kërkesa, edhe në rast se na, për shembull, vendosim këtu me i dhënë shuma ma shumë se 1000 euro, atëherë shpenzohen mjetet për tre muaj edhe nuk kemi me pas mundësi me iu ndihmue të gjithëve. Unë ju kisha lut që për kërkesën e Almirit m'u vendos sot, votoni, edhe për tri kërkesat tjera me ia bart Zyrës së Kryetarit. Qekaq.

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri kryetar! Kërkesa e kryetarit është që kërkesa e zotit Almir Ibrahim të miratohet, propozim i kryetarit edhe i delegatëve është që kërkesa e zotit Almir Ibrahim të miratohet, ndërsa tri kërkesat tjera t'i kalojnë Zyraës së Kryetarit. Do të shkojmë me votim. Tri kërkesa barten, ni kërkesë subvencionohet, me shumën e kërkuar në vlerë prej 1800 eurosh. Kush është pro këtij propozimi? Konstatoj që me 7 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, kalon pika, mas shumë diskutimeve, e politizimeve, e muhabetëve shpeshherë edhe të kota. Po vazhdojmë te pika eventuale. Mundeni me e marrë fjalën kush do me diskutue eventuale. Artani e ka fjalën.

Artan Loshaj: Masi nuk na dhaje replikë, kryesues, p'e shfrytëzoj...mirë de, okej, faleminderit, po due me shfrytëzue rastin edhe në eventuale me asi. Unë ni vërejtje, për juve, është që çdo kërkesë që bohet, herave tjera të bohet, secila kërkesë është bo veç e veç, edhe secila kërkesë të shqyrtohet veç e veç. Sot votova për hir të gjendjes së pacientit, se s't'i kishom votue kreta n'paketë. Me zotni kryetarin dy kërkesa i kom, njona që nuk kërkove falje, le të jetë në ndërgjegjen tonde që më ofendove, s'e kam prit prej teje, se e di që je humanist edhe je shumë njerëzor, po më çudite sot që nuk dole me kërkue falje, kërkimfalja, veç burrat e bojnë. Edhe ni tjetër send është ni kërkesë e imja dhe e qytetarëve të fshatit Rrenc, të kam kërkue ja dy herë në zyrë, nuk ke qenë, je konë i angazhuet, kam bisedue me zotëri Resulin, me nënkryetarin. Çështja e imja dhe e qytetarëve të fshatit Rrenc, po me siguri edhe e Arijetës, tenderin e ujit të pijshëm, i famshmi tender i PDK-së që e keni qit këtë vit në tender, ju përgëzoj, ishalla e realizoni. Është ni kërkesë e qytetarëve të fshatit Rrenc që kur të vënë gypat në hyrje të fshatit, me mund ti, në qoftë se kie vullnetin dhe dëshirën, me bo ni takim me qytetarët e fshatit Rrenc, o në Rrenc ju presim bashkë me Arijetën, ose me na prit neve ni delegacion, pa politikë, se prej – që kie qef me ardhë, patjetër, e para je, bile mundish me e marrë bajrakin për ndonjë votë helbete, po e di që s'e bojsh atë – problemi është kështu që, prej daljes së tenderit deri më sot, në atë trasenë ku shkon uji kemi bo shumë investime,

edhe PDK edhe ju si parti në pushtet. Kemi mundësi me e ndërrue trasenë, për mos me bo krejt investime mbi 200-300 mijë euro me shkue në ujë se, kam bisedue edhe me drejtorin e Urbanizmit, minimum 1 metër e 20 ka me hi gypi nëpër fshat, rruga është 1 metër e gjys, domethënë mbi dy kilometër rrugë të asfaltume, edhe mbi 700-800 metër asfalt që e kemi tenderin Rrenc-Kapre, duhet m'u prish. E për mos m'u bo ky investim i gabuar, na kemi mundësi – se mos me pas mundësi nëpër Rrenc, bon – po kemi mundësi, e kemi këqyrë edhe në Urbanizëm, kemi dy mundësi; me shkue në anën e djathtë të Rrencit, kah shpiat e zonjës delegate, edhe ana tjetër është me shkue kah shkolla e re, stadioni, me dalë te lapidari, me dalë edhe ma shkurt edhe me shkue të bazeni, mos me e prish infrastrukturën nëpër fshatin Rrenc. Edhe ni herë kërkoj nga ti ni përgjigje, a e kie vullnetin, kur e kie mundësinë, kur je ma i lirë, o në Rrenc me ardhë me ni takim me nënkryetarin edhe me Arijetën edhe unë, me shkue bashkë. Në qoftë se menojsh që është politike, vij si qytetar ulem atje i fundit, veç është mirë me pas ni takim, o është mirë me bo ni takim me na prit në zyrë ni ditë, me na caktue orën edhe vendin edhe krejt. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Loshaj! Fjalën e ka...okej, kryetari e ka fjalën.

Bexhet Xheladini: Duke marrë parasysh se nga momenti kur PDK e ka marrë qëndrimin, pushteti i kaluar, me e bo Ujësjiellësin, ka kalue ni kohë e gjatë, edhe ndërkohë janë bo shumë investime, jo vetëm në Rrenc, po edhe në vendet tjera, unë e kam bo ni urdhëresë në Drejtoratin e Urbanizmit që ky projekt të revidohet, do të thotë t'u e marrë parasysh gjendjen në terren. Edhe inxhinierat e Komunës kanë punue afër ni muaj ditë, edhe e kanë bo revidimin e këtij projekti. Do të thotë, traseja nuk do të shkojë aty ku ka qenë e parapame para 10 vjete, apo 8 vjete apo 9 vjete, por janë bo disa ndryshime për hir që, do të thotë, edhe projekti të kushtojë ma lirë edhe mos t'i prishim rrugët të cilat janë të asfaltume ose të kubëzume. Unë delegacionin e pres, edhe vetëm duhet me më tregue ma herët, edhe unë i thirri inxhinierat e Komunës, edhe kanë me ju tregue saktë kah ka me shkue traseja nëpër fshatin Rrenc. Nëse është tejkalue ky problem, atëherë s'kemi nevojë me debatue ma shumë, nëse nuk është tejkalue, unë jam për me i zgjidhë problemet edhe dëmi me qenë shumë ma i vogël.

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Fjalën e ka zoti Jonuzi.

Munir Jonuzi: I nderuar Kryesues, këtu i vetmi që bën politikë për çështjet që lidhen me sëmundjet dhe kërkesat e njerëzve jeni vetëm ju. Askush tjetër përveç jush nuk përmendi donatorët e ndryshëm. Ajo që më shqetëson veçanërisht është ajo që më the me një fjali: nëse kjo kërkesë

kalon, atëherë kalojnë të gjitha kërkesat, ne do ta shqyrtojmë gjithçka në këtë mënyrë”. Ne do, do t’i konsiderojmë të gjitha, por nuk mund t’i trajtojmë të gjitha sëmundjet në të njëjtën mënyrë. Sëmundjet ndryshojnë. Edin Kurt donte vetëm të mësonte për aplikantin, nëse ai është anëtar i një komuniteti pakicë. Na akuzoni menjëherë se po bëjmë politikë. Ne nuk bëjmë asnjë politikë. Ne thjesht duam dhe kërkojmë informacion. Kur të thuash për një rast nga fshati yt, mos e ruajt Zoti të jetë kështu, do t’ju besojmë, sepse ju e dini më së miri gjendjen në fshatin Bllaçë. Zoti Kryesues, pozita e nënkryetarit të kuvendit më dha populli. Ju nuk më keni votuar, nuk më ka votuar asnjë delegat, por kështu thotë Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, se ai që ka më shumë vota në listë është automatikisht nënkryetari i Kuvendit. Dhe duhet ta dini se ne të gjithë jemi përfaqësues të popullit këtu, pavarësisht nga kombi. Veç që une kam obligim shtesë që të kujdesem për të drejtat e komunitetit joshumicë. Ju nuk mund të dërgoni menjëherë një kërkesë nga një komunitet jo-shumicë te disa donatorë. Pse nuk ndajmë fonde. Ju keni bërë politikë nga ky rast, jo ne.

Uran Halimi: Je shumë gabim, zoti Jonuzi. S’pat të bëjë me atë se kush të ka zgjedhë, ose qysh të ka zgjedhë, se s’është problemi i jam ai, as që e kam diskutue atë çështje. Je zëvendëskryesues, të kam përgëzue edhe e kam respektue atë, diçka që është e ndodhme. Sa i përket politikës, unë nuk thash që me kërkue subvencione e ndihma prej komunitetit, vetë e politizuet atë Zyrën e Komuniteteve, jo i ndihmon jo s’i ndihmon, e dini shumë mirë, unë kurgjo s’përmenda. Unë as s’e njoh, edhe për diçka që s’e njoh unë s’mundi me thonë. E politizuet çështjen shumë qartë, Zyra e Komunitetit, i besoj, s’i besoj. Përfaqësuesi i juaj është ai, qysh s’po i besoni? Përfaqësuesi i Zyrës për Komunitete. Unë i besoj që s’e njoh, a ju që s’i besoni edhe e keni në krye, ajo është çështje e juaja. Fjalën e ka zoti Edin Kurt.

Edin Kurt: Unë kam një kundërshtim për ju, ju përmendët emrin tim pak kohë më parë dhe nuk më dhatë të drejtën të përgjigjem. Ju kërkoj të respektoni ligjin. Besoj se nuk kam thënë asgjë të gabuar. Dhe sa i përket besimit, ky është mendimi im personal. I besoj apo jo njeriut, kërkoj që Komisioni për Politikë dhe Financa t’i miratojë këto fonde. Unë thashë se kjo është kërkesa e vetme që kemi marrë deri më tani nga komuniteti jo-shumicë. Nuk më kuptove mirë ose nuk dëshiron të më kuptosh. Deri më tani, sa herë që vinin kërkesa nga komuniteti shumicë, unë gjithmonë votoja ashtu siç keni votuar ju. Jo vetëm ju personalisht, por të gjithë ju nga komuniteti shumicë, sepse besoj se i njihni këta persona dhe besoj se nëse kërkesa ka mbërritur këtu dhe nëse po e paraqisni, unë duhet të mbështes çdo kërkesë të tillë.

Uran Halimi: Fillimisht po due me ta përgënjeshtërue këtë që është e vetmja kërkesë, se nuk është e vetmja kërkesë. Kërkesat tjera që shumë s'ju ka pëlqye me u marrë, ia keni delegue kryetarit me zero diskutim. Ka pas kërkesë prej komunitetit joshumicë edhe ma herët, këtë e di shumë sigurt, nëse doni i shfletojmë edhe jau prezantojmë. Ato mendimet e juaja personale që i keni, mundeni m'i mbajt personalisht, po përderisa dilni edhe folni këtu, besoni ose s'besoni, ju e shpërndani ni informacion, a po kupton. Mundesh me e marrë fjalën për replikë. Jo, Edini e ka ni minutë.

Edin Kurt: Zoti Kryesues, thashë që meqenëse jam anëtar i Komisionit për Politikë dhe Financa, kjo është e vetmja kërkesë që kemi marrë për shqyrtim. Ndoshta ka pasur kërkesa të tjera më herët ose ndoshta ka pasur kërkesa që kanë ardhur por nuk janë hedhur në votim. Jam një djalë i ri dhe kujtesa më shërben shumë.

Uran Halimi: Veç po due me të kallxue që je konë prezent fizikisht, në atë aspektin tjetër a je konë a jo, ti e dish. Fizikisht je konë prezent. Përktheja të lutem, Suad! Fizikisht je konë prezent, këtë ta garantoj, ama në aspektin tjetër a je konë a jo, ajo është çështje e jotja. Ni minutë replikë e ka Artan Loshaj dhe pas tij Munir Jonuzi.

Artan Loshaj: Kryetar, rreth ujësjellësit nëpër fshatin Rrenc, mirë ke bo që ke dhënë urdhër m'u krye, edhe këtë informatë nuk e kam marrë atje poshtë e me ardhë e me thonë këtu, qysh më thaje ma herët, që më thaje p'i marrish informatat edhe po vijsh p'i biesh në Kuvend, nuk kam marrë. Unë kam diskutue me ata, ti me siguri masi unë kam bo kërkesë te ta, ty të kanë kërkuë ata, ose të ka njoftue kryesuesi, nuk e kanë mat. Ke dhonë urdhër me mat, edhe është mirë, po hala nuk është bërë matja, e di shumë sigurt se çdo dy ditë vij, nashta edhe i kam mërzit aty. Faleminderit që po na presish, që thaje kur të doni ju, jo, na jemi të gatshëm kur të je ti i gatshëm, se ti je kryetari. Na të respektojmë për kryetar, pa marrë parasysh a të kemi votue a jo. A ka mundësi me na kallxue datën, orën, ti kur po na presish. Edhe po due me e marr ni informacion prej Arijetës, a po vjen kjo, se në qoftë se vjen edhe Arijeta, t'ju shohim ju dy kur jeni të lirë, se unë edhe me fshatarët jemi 24 orë, si Big Brother, jemi të lirë kur të thuesh ti. Edhe e fundit, prapë nuk më dhaje përgjigje për bullizmin edhe injorimin, pse s'po kërkojsh falje edhe ku është problemi.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Loshaj! Ni minutë replikë zoti Jonuzi.

Munir Jonuzi: Kur folët pak më parë, më drejtuat nëse i besoj apo jo zyrës së komunitetit. Unë nuk e thashë atë. Besoj apo jo, ju duhet të pranoni mendimin tim, qëndrimin tim. Nuk do të më

vrasësh sepse mendoj ndryshe nga ti, apo jo? Sa i përket kërkesës, kjo është realisht kërkesa e parë që vjen nga një komunitet jo-shumicë që po shqyrtojmë në këtë komision. Këtu ju sfidoj të tregoni se çfarë kërkesë tjetër nga komuniteti joshumicë kemi shqyrtuar. Përsa i përket presidentit, ai mori në konsideratë ndoshta qindra prej tyre, por ne si komision i politikave të financave po shqyrtojmë për herë të parë një kërkesë të tillë. Dhe kjo është arsyeja pse ne nuk kuptohemi kur ju thoni të dërgojmë një kërkesë për donatorët. Mund të kemi pasur disa kërkesa në muajin dhjetor por nuk i kemi marrë parasysh, nuk ka pasur para dhe nuk i kemi marrë parasysh. As nga shumica dhe as nga komuniteti joshumicë. Ju vetë thatë se kemi disa kërkesa, por nuk kemi fonde dhe nuk do t'i shqyrtojmë.

Uran Halimi: Shumë faleminderit, zotëri Jonuzi! Për shkak që unë nuk e njoh gjuhën boshnjake, bile bile e mbaj në mend shumë mirë që ta kam dhonë ty me e lexue kërkesën e...kjo është shumë e sigurt, vetë e ke lexue, edhe është votue për me kalue, e kemi marrë ni vendim, vetë e ke çue dorën, bashkë me anëtarët tjerë. Hiç s'e ke trajtue, veç e ke kalue, bashkë me mu edhe anëtarët tjerë të Komitetit. A ka dikush tjetër nëse do me diskutue për ndonjë pikë tjetër, për ndonjë çështje tjetër, përveç këtyre që i cekëm deri tash? Nëse jo, faleminderit për pjesëmarrjen. Kryetari po besoj që munden me e këqyrë kur munden me konë i lirë, unë po besoj që kryetari duhet me e këqyrë agjendën qysh e ka.

Bexhet Xheladini: Nuk të kam ofendue, për atë s'kam nevojë me të kërkuë falje. Jo. Edhe nëse e ke marrë ti për ofendim, unë qëllimin nuk e kam pas me të ofendue. Sa i përket kërkesës tuaj për me prit ni delegacion të fshatit Rrenc, unë pas përfundimit të Asamblesë Komunale, nëse përfundon në ora dy, ju kisha prit në ora dy, masi është edhe Arijeta nesër, edhe ti je nesër këtu, edhe ata le të vijnë, por edhe në ora tre unë ju pres, deri në tre e gjys ju pres, nuk është problem, do të thotë mas përfundimit të Asamblesë, nëse përfundon ma herët, kur të përfundojë, atëherë...ose e lëmë në ora dy e gjys. Po e lëmë në ora dy e gjys, a po? Okej.

Uran Halimi: Faleminderit për durimin! Mirë u pafshim në takimet e radhës!

Kryesuesi

Uran Halimi